



Mekanizmi Parandalues Nacional, më datë 23.05.2017, realizoi vizitë të paparalajmëruar për rikontroll në Burgun Kumanovë. Vizita u realizua në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokolli Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Mekanizmi Parandalues Nacional, më datë 19.12.2014 realizoi vizitë të rregullt në Burgun Kumanovë, për çka përpiloi Raport të posaçëm me konstatime dhe rekomandime përkatëse, të cilin ia dërgoi drejtorisë së këtij institucioni ndëshkues-korrektues dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vizitës për rikontroll, në përbërje të ekipit të Mekanizmit Parandalues Nacional, u përfshinë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm, përfaqësuesit e Shoqatës së Psikiatërve dhe përfaqësuesit e Dhomës së Psikologëve të RM. Qëllimi i vizitës për rikontroll ishte përcaktimi i shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga Raporti i posaçëm i MPN për vizitën e realizuar në fund të vitit 2014 dhe identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Institucioni ka në dispozicion kapacitete të vendosjes për 200 persona të dënuar të cilët e vuajnë masën e paraburgimit. Në momentin e vizitës për rikontroll, në INK Burgu Kumanovë ishin regjistruar 142 persona të dënuar, 14 persona të paraburgosur të vendosur në pjesën e paraburgimit dhe 9 persona, të cilët deri në ditën e realizimit të vizitës nga MPN, ishin në arrati.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vizitës u fokusua në përcaktimin e shkallës së implementimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin e posaçëm nga vizita e rregullt e cila u realizua në fund të vitit 2014, i përpiluar në datën 23.03.2015, në drejtim të përmirësimit të gjendjeve dhe eliminimit të mangësive dhe rreziqeve të cilat do të mund të çonin deri në torturë ose trajtim tjetër brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Mekanizmi Parandalues Nacional, nga këqyrja mbi kushtet materiale të Repartit të paraburgimit konstatoi se gjendja me sistemin e thirrjes nuk ka ndryshuar, më saktësisht gjatë kohës së vizitës për rikontroll ekipi i MPN konstatoi se sistemi për thirrje (alarmi) në asnjërën nga hapësirat akoma nuk ishte funksional, kështu që personat e paraburgosur detyrohen që me trokitje në dyer të alarmojnë kur kanë nevojë, me qëllim që të vendosin komunikim me të punësuarit e Sektorit për sigurim.

Gjatë vizitës së parë, Mekanizmi Parandalues Nacional i dha rekomandime Drejtorisë së Burgut të ndërmarrin aktivitete në mënyrë që nga kushtet e jashtme klimatike të mbulohet hapësira për shëtitje deri tek pjesa e paraburgimit, me çka personat e paraburgosur papengesë të mund ta shfrytëzojnë edhe gjatë kushteve të këqija klimatike. Nga këqyrja e realizuar gjatë vizitës për rikontroll, MPN-ja konstatoi se hapësira edhe më tej është e pambrojtur, kështu që në situata kur kushtet klimatike janë të pa favorshme, personave të paraburgosur u pamundësohet dhe u vështirësohet realizimi i të drejtës për shëtitje në ajër të pastër.

Gjatë vizitës së parë iu dha rekomandimi Drejtorisë së Burgut të mundësoj shfrytëzim pa pengesë të ujit, si për pije, ashtu edhe për kryerjen e nevojave fiziologjike dhe higjienike dhe ngrohje të mjaftueshme në hapësirat konform standardeve të përcaktuara ndërkombëtare. Në vizitën për rikontroll, nga këqyrja në hapësirat në të cilat janë vendosur personat e dënuar dhe në hapësirat e paraburgimit, si dhe nga bisedat me personat e paraburgosur dhe personat e dënuar, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se edhe më tutje nuk është zgjidhur problemi me mungesën e sasisë së mjaftueshme të ujit në Burgun Kumanovë për funksionim normal të institucionit. Pikërisht për këtë qëllim, në hapësirat e burgut u vërejt shfrytëzim masiv i shisheve plastike të mbushura me ujë.

Sa i përket ngrohjes së hapësirave, duke e marrë parasysh faktin se vizita u zhvillua në muajin maj, kur ishte ngrohtë dhe kur nuk ishte sezon i ngrohjes, MPN-ja informohej vetëm nga deklaratimet e personave të dënuar dhe të paraburgosur të cilët theksonin se institucioni edhe më tej ka problem me ngrohjen gjatë periudhës së dimrit, e që do të thotë se edhe më pas nuk është vepruar sipas rekomandimit të dhënë nga MPN-ja sa i përket ngrohjes së hapësirave.

Gjatë vizitës së parë, MPN-ja konstatoi se kishte kategori të ndryshme të personave të dënuar, kështu që në këtë drejtim drejtoi rekomandim deri te Drejtoria e Burgut që të ndërmerren masa urgjente me të cilat do të kufizohet përzierja e kategorive të personave të dënuar, si dhe realizimi i trajtimit të cilin e kanë fituar të njëjtit. Nga vizita e realizuar për rikontroll në Burgun Kumanovë, u konstatua se vazhdon të mbetet i pazgjidhur problemi me përzierjen e kategorive të personave të dënuar të cilët nuk janë klasifikuar dhe shpërndarë në mënyrë përkatëse, duke e marrë parasysh peshën e veprës penale, sanksionin e caktuar penal, si dhe të dhënat e tjera të cilat vlerësohen gjatë klasifikimit të personave të dënuar.

Ekipi i MPN-së gjatë vizitës së parë dha rekomandim që Sektori për risocializim të vendos raport ndaj personave të dënuar me respektimin e tyre, si dhe t'i motivoj dhe mbështes personat e privuar nga liria në pjesën e përmirësimit të personalitetit dhe reduktimit të mundësisë nga recidivizmi. Mekanizmi Parandalues Nacional nga vizita për rikontroll, nga bisedat me personat e dënuar, si dhe me njërin nga edukatorët e Burgut, konstatoi se sa i përket zbatimit të procesit të risocializimit, për shkak të numrit të vogël të edukatorëve dhe mungesës së personave të punësuar në këtë Sektor, procesi zbatohet vetëm në atë mënyrë me të cilin edukatorët zhvillojnë biseda individuale edhe atë, në të shumtën e rasteve, me kërkesë dhe insistim të personave të dënuar. Për shkak të numrit të madh të personave të dënuar dhe pamundësisë që të arrihet përkushtimi i vëmendjes për çdo person veç e veç, praktikisht nuk zbatohen trajtimet individuale dhe kolektive.

Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë realizimit të vizitës për rikontroll në Burgun Kumanovë, përveç se i përkushtoi vëmendje të veçantë vlerësimit të zbatimit dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga raporti i cili buroi nga vizita e rregullt, zbatoi këqyrje edhe mbi gjendjet e reja, përmes të cilave do të mund të identifikohen rreziqet e identifikuar, me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Nga bisedat e zhvilluara me personat e paraburgosur, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se personat e paraburgosur janë të kënaqur nga trajtimi i Sektorit të sigurisë dhe nga realizuesit e tjerë të Burgut Kumanovë, janë të kënaqur nga ushqimi në Burg dhe cilësia e sasia e të njëjtit, nuk kanë vërejtje sa i përket realizimit të të drejtave të tyre për kontakt ose vizitë nga familja, si dhe gjithashtu, të drejtat të cilat i gëzojnë konform rendit të shtëpisë në institucionin ndëshkues-korrektues, kështu që si problem më të madh e potencojnë problemin me mungesën e ujit dhe

ngrohjes së hapësirave gjatë periudhës së dimrit. Po ashtu, një pjesë e personave të dënuar të fesë myslimane shprehën pakënaqësi për shkak se, ushqimi që shërbehet në Burgun Kumanovë, sipas tyre, nuk i përshtatet mënyrës së tyre të të ushqyerit.

Një pjesë e madhe e personave të dënuar u ankuan lidhur me të drejtën e paraqitjes së parashtrësës dhe ankesës përmes sëndukut të vendosur nga Avokati i Popullit, me ç'rast theksuan se i njëjti është vendosur në një vend të papërshtatshëm, përkatësisht gjendet menjëherë pranë pulit prej qelqi ku qëndrojnë personat zyrtarë të Sektorit të sigurisë. Në këtë mënyrë, personat e dënuar gjatë çdo paraqitje të parashtrësës në sënduk i nënshtrohen mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të policisë së burgut, me çka pamundësohet e drejta e anonimitetit dhe privatësisë gjatë paraqitjes së parashtrësës dhe personat e njëjtë do të mund të kenë probleme të mëtutjeshme gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të tyre.

Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional, reagoi edhe gjatë kohës së vizitës së rregullt sa i përket vendosjes së sëndukut për paraqitjen e parashtrësave dhe ankesave, duke kërkuar që i njëjti të rivendoset në vend adekuat që do të garantoj anonimitetin e personave të dënuar, megjithatë, shpreh shqetësim se edhe më tutje gjendet në vendin e njëjtë, dhe për këtë shkak sugjeron dhe kërkon të vepronet sipas sugjerimit dhe sënduku të vendoset në vend adekuat.

Për dallim nga vizita e rregullt e realizuar më datë 19.12.2014, kur pjesa më e madhe e personave të dënuar shprehën pakënaqësi nga numri i vogël i personave të dënuar të angazhuar me punë në Burgun Kumanovë, gjatë kohës së vizitës për rikontroll, si nga bisedat e zhvilluara me personat, ashtu edhe nga këqyrja mbi dokumentacion të cilin e zbaton, Ekipi i MPN konstatoi se është vepruar sipas rekomandimit të dhënë për angazhimin me punë të të gjithë atyre personave të cilët janë të aftë për aktivitete fizike dhe për punë, me çka do ta plotësojnë kohën gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burgim.

Si rezultati i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport, në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe drejtorit të Burgut Kumanovë, me qëllim të eliminimit të rreziqeve dhe mangësive.